

Case study

© 2019 Edjol Malo & Endri Malo.

This is an open access article licensed under the Creative Commons Attribution-Non-Commercial NoDerivs License ([Creative Commons Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/))

PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT NGA STUDENTËT

Edjol MALO¹ & Endri MALO²

^{1&2}Diplomuar Mesues për Arsimin e Mesëm në Matematikë

edjolmalo@gmail.com

endrimalo97@gmail.com

Abstract

Corruption has been known since ancient times. Although it existed in all parts of the world, societies have often shunned discussion about this reality. The word corruption is a vague term. Even in the professional literature it contains different and undefined meanings. This definition is as diverse as the ideas of international governmental and non-governmental organizations.

But in general, all sources define corruption as the abuse of public power for personal gain, such as bribery by public servants, collusion in public procurement, or misappropriation of public funds. In a word we can say that: anyone who serves himself, immorally and unethically, is corrupt. Specifically, this study presents data on students' perceptions of corruption in Albania.

The data presented here are based on the results of questions conducted with Google Form2 where 64 students of the University of Vlora "Ismail Qemali" participated. Participants in this research were asked about their perceptions of corruption, experiences with corruption cases in public institutions, the acceptability of corrupt behavior in public institutions, the tendency to offer bribes, etc.

We hope to have done a valuable job in relation to this phenomenon which day by day is filling us day with the news and chronicles that it occupies in the mass media and beyond

Key words: corruption, student, corruption perception, students,

Abstrakt

Korrupsioni është i njohur që nga kohët më të lashta. Edhe pse po ekzistonte në të gjitha pjesët e botës, shoqëritë shpeshherë i kanë ikur diskutimit rreth këtij realiteti. Fjala korrupsion është një term i paqartë. Edhe në literaturën profesionale përmban kuptime të ndryshme dhe të pa përcaktuara. Ky definicion është aq i lloj-llojshëm, aq sa janë edhe idetë e organizatave ndërkombëtare qeveritare e joqeveritare.

Në vija të përgjithshme, të gjitha burimet e përkufizojnë korrupsionin si shpërdorim të pushtetit publik për përfitime personale, siç është mitmarrja, nga nëpunësit publikë, marrëveshjet e fshehta në prokurimet publike ose përvetësimi i fondeve publike. Me një fjalë mund të themi se: çdokush që i shërben vetes, në mënyrë jo morale dhe jo etike, është korruptor.

Konkretisht ky studim paraqet të dhëna mbi perceptimin e studentëve ndaj korrupsionit në Shqipëri. Të dhënat e paraqitura këtu janë të bazuara në rezultatet e pyetjeve të kryera me Google Form¹ ku morën pjesë 64 studentë të Universitetit të Vlorës “Ismail Qemali”. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim janë pyetur për perceptimet e tyre për korrupsionin, përvojat me raste korruptive në institucione publike, pranueshmërinë e sjelljeve korruptive në institucionet publike, tendencën për të ofruar ryshfet etj.

Shpresojmë që të kemi bërë një punë vlefshme në lidhje me këtë fenomen i cili dita – ditës po na mbush ditën më lajmet dhe kronikat që zë nëpër masmedia dhe më gjerë.

Fjalët kyçe: *korupsion, student, perceptim i korupsionit*

1. HYRJE**1.1. Shpërndarja gjinore**

Në anketim morën pjesë 64 studentë prej të cilëve 35 ishin meshkuj dhe 29 femra, përkthyer në përqindje respektivisht 54.7% dhe 45.3%. Shohim se kemi një shpërndarje pothuajse të barabartë gjinore.

1.2. Shpërndarja moshore

Shpërndarja moshore varion nga 17 vjeç deri në 30 vjeç me një mesatare 22.06 dhe devijim standard 2.811. Moda është 23 vjeç me një frekuencë 14 e cila përben 21.9% të vlerave.

Tabele Nr.1 Përshkrim statistikor

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
2. Moshë Valid N (listeise)	64	17	30	22.06	2.811


Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

¹https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSdbYLhYKtX1AIGxUI25qQVGWZYTp4c7BmWQnlmkc2H1QKZdZQ/viewform?usp=sf_link

1.3. Të ardhurat mesatare të familjeve të studentëve

Për sa i përket pyetjes mbi të ardhurat familjare, shumica e studenteve rreth 37.5% janë përgjigjur që familja e tyre ka të ardhura mesatare midis 18001 – 35000 lekë, më pas kemi rreth 32.5% me të ardhura familjare 35001 – 87000 lekë. Ndërsa studentët me të ardhura familjare mbi 87000 lekë janë vetëm 4.69%. Duhet përmendur fakti se 18.75% e familjeve kanë të ardhura me te pakta se 18000 lekë. Duke u nisur nga këto të dhëna kemi që 56.25% e studentëve vijnë nga familje me të ardhura nën 35000 lekë gjë e cila duhet konsideruar tepër shqetësuese

Grafik Nr. 1. Paraqitje grafike e rezultateve të pyetjes: “Sa të kënaqur jeni me gjendjen financiare individuale”




Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Për sa i përket gjendjes financiare individuale shohim se pjesa më e madhe e studentëve (34.38%) janë mjaft të sigurtë, kurse 29.69% janë të pasigurt dhe 26.5% janë shumë të pasigurtë. Ndërkohë që vetëm 7.81% e studentëve janë shumë të sigurtë me gjendjen financiare individuale.

1.4. Shqetësimet

Të pyetur se cili është problemi më shqetësues për qytetarët e Shqipërisë shumica e studentëve të anketuar apo rreth 29.69% e tyre kanë zgjedhur papunësinë si problemin më shqetësues.

Grafik. Nr.2, Paraqitje grafike e rezultateve të pyetjes: Sipas jush cili nga problemet e mëposhtme është me shqetësues për qytetarët e Shqipërisë?



Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Si kategoria e dytë më e përzgjedhur është qeverisja e keqe me 25%, kurse korrupsioni është kategoria e tretë me 23.44%. Kategoria me pak e përzgjedhur është problemet politike me vetëm 3.13%.

1.5.Kërcënimi i sigurisë

Të pyetur për 5 fenomene, se për cilin prej tyre ndihen më shumë të kërcënuar vihet re që shumica e studentëve të anketuar rreth 59.38% kanë zgjedhur korrupsionin si fenomenin më kërcënues për ta. Kjo është dukshëm një përqindje tepër e lartë në krahasim me fenomenet e tjera, ku vrasjet përbejnë 17.19%, krimi i organizuar me 10.94%, vjedhjet me 9.37% dhe fenomeni për të cilin studentët ndihen më pak të kërcënuar aksidentet e trafikut me vetëm 3.12%.

Tabela Nr. 2, rezultatet e pyetjes “Për cilin nga fenomenet e mëposhtme ndiheni me shumë të kërcënuar.”


	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Aksidentet e traut	2	3.1	3.1	3.1
Korrupsioni	38	59.4	59.4	62.5
Krimi organizuar	7	10.9	10.9	73.4
Vjedhjet	6	9.4	9.4	82.8
Vrasjet	11	17.2	17.2	100.0
Total	64	100.0	100.0	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

1.6.Niveli i korrupsionit

Nga grafiku shohim se shumica e studenteve 59.38% kanë perceptimin që niveli i përgjithshëm i korrupsionit në Shqipëri është shumë i lartë, kurse 25% mendojnë që niveli i korrupsionit është i lartë.

Grafik Nr.3, Paraqitje grafike e rezultatit të pyetjes për nivelin e perceptimit të korrupsionit



Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit


Ndërkohë vetëm 4.6% e të anketuarve kanë zgjedhur përgjigjen “i ulët” dhe asnjë student nuk

ka zgjedhur përgjigjen “shume i ulet” (kjo përgjigje nuk është paraqitur ne tablele).

1.7.Arsyeja e prezencës së korrupsionit

Për sa i përket arsyes kryesore të prezencës së korrupsionit në Shqipëri shumica e studentëve rreth 32.81% kanë perceptimin që arsyeja kryesore e prezencës së korrupsionit është dëshira për pasurim të shpejtë.

Grafik Nr. 4. Paraqitje grafike e rezultatit te pyetjes “Cila është arsyeja kryesore e prezencës së korrupsionit në Shqipëri



Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Kategoria e dytë më e përzgjedhur është kriza morale me 20.31%, kurse kategoria e tretë më e përzgjedhur është mungesa e kontrollit strikte administrative me 18.75%. Kategoria më pak e përzgjedhur është “pagat e ulëta të zyrtarëve të sektorit publik”.

1.8.Prania e korrupsionit në institucione

Të pyetur për korrupsionin (ku 1 nënkupton që nuk ka fare korrupsion dhe 5 korrupsioni është shumë I larte) në gjykate shumica e studentëve (37.5%) e kanë vlerësuar me “5” nivelin e korrupsionit në institucionet e gjykatave. Asnjë prej të anketuarve nuk ka dhënë vlerësimin “1”, pra që nuk ka fare korrupsion dhe 7.8% e tyre kanë dhënë vlerësimin “2”.

Tabela Nr. 3, Rezultatet e pyetjes për praninë e korrupsionit në gjykatë


	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
2	5	7.8	7.8	7.8
3	22	34.4	34.4	42.2
4	13	20.3	20.3	62.5
5	24	37.5	37.5	100
Total	64	100	100	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Ndërkohë 34.4% kanë dhënë vlerësimin “3” dhe 20.3% kanë dhënë vlerësimin “4”. Nga këto të dhëna mund të themi se studentet kanë mendimin që niveli i korrupsionit në institucionin e gjykatave është tepër i lartë.

Përsa i përket nivelit të korrupsionit në prokurori kemi që 40.6% e studentëve kanë dhënë vlerësimin “3” dhe 33.81% e tyre kanë dhënë vlerësimin “5”, pra që korrupsioni është shumë i lartë.

Grafik Nr. 5. Paraqitje grafike e rezultatit të pyetjes për nivelin e korrupsionit në prokurori



Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Vetëm 1.56% e studentëve mendojnë që në institucionin e prokurorisë nuk ka fare korrupsion. Edhe në këtë rast (duke parë edhe grafikun më sipër) mund të themi se tek studentët kanë perceptimin që në prokurori niveli i korrupsionit është i lartë.

Nga tabela shohim se shumica e të anketuarve 35.9% e kanë vlerësuar me “3” nivelin e korrupsionit në policinë e shtetit, pra shumica e studentëve mendojnë që ka një nivel mesatar të korrupsionit në policinë e shtetit. Më pas kategoria e dytë më e përzgjedhur me 23.4% është numri “5” që nënkupton një prani të lartë të korrupsionit.

Tabele Nr. 4, Rezultat e pyetjes mbi perceptimin e korrupsionit në policinë e shtetit


	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
1	2	3.1	3.1	3.1
2	12	18.8	18.8	21.9
3	23	35.9	35.9	57.8
4	12	18.8	18.8	76.6
5	15	23.4	23.4	100
Total	64	100	100	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Për sa i përket korrupsionit në shëndetësi shohim se shumica e të anketuarve kanë dhënë vlerësimin “4” që nënkupton një nivel të lartë prezencës së korrupsionit. Më pas me të njëjtën përqindje 21.88% janë zgjedhur vlerësimet “3” dhe “5”.

Grafik Nr. 6. Paraqitje grafike e rezultatit të pyetjes për nivelin e korrupsionit në shëndetësi

10. Nga 1 deri ne 5 (ku 1 nenkupton qe nuk ka fare korrupsion dhe 5 niveli i korrupsionit eshte shume i larte), sa i pranishem eshte sipas jush korrupsioni ne institucionet e meposhtme. [Shendetesia]



Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Tabela Nr. 5, Rezultat e pyetjes mbi perceptimin e korrupsionit në arsimin e lartë

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
1	1	1.6	1.6	1.6
2	8	12.5	12.5	14.1
3	16	25	25	39.1
4	23	35.9	35.9	75
5	16	25	25	100
Total	64	100	100	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Nga tabela shohim që shumica e studentëve reth 35.95% e kanë vlerësuar me “4” nivelin e korrupsionit në Institucionet e Arsimit Të Lartë, pra pjesa më e madhe e studentëve mendojnë që ekziston një nivel i lartë i korrupsionit në Institucionet e Arsimit Të Lartë. Më pas me të njëjtën nivel përqindjeje (25%) studentët kanë dhënë vlerësimet “3” dhe “5”.

Tabela Nr. 6, Rezultat e pyetjes mbi perceptimin e Pranueshmërisë për dhënien e favoreve ne spital

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Shumë papranueshme	30	46.9	46.9	46.9
E pranueshme	15	23.4	23.4	70.3
Disi e pranueshme	9	14.1	14.1	84.4
E pranueshme	3	4.7	4.7	89.1
Shumë e pranueshme	7	10.9	10.9	100
Total	64	100	100	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Në lidhje me pyetjen se sa e pranueshme është që një person të japë para të gatshme të japë dhurata apo favore në këmbim të ndihmës së zgjidhjes së një problem në spital shumica prej të anketuarve rreth 46.9% e tyre kanë mendimin që ky veprim është shumë i papranueshëm. Më pas kategoria e dyte më e përzgjedhur me 23.4% është kategoria “e papranueshme”.

Tabela Nr. 7, Rezultat e pyetjes mbi perceptimin e Pranueshmërisë për dhënien e favoreve ne shkollë


	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Shume e papranueshme	30	46.9	46.9	46.9
E papranueshme	15	23.4	23.4	70.3
Disi e pranueshme	9	14.1	14.1	84.4
E pranueshme	3	4.7	4.7	89.1
Shume e pranueshme	7	10.9	10.9	100
Total	64	100	100	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit


Shumica e të anketuarve 39.1% kanë mendimin që të japësh favore për zgjidhjen e një problem në shkollë është shumë e papranueshme. Më pas 25% e studentëve të anketuar mendojnë që dhënia e favoreve ne shkollë është disi e pranueshme.

Shumica e studentëve të anketuar rreth 39.6% mendojnë që është shumë e papranueshme dhënia e favoreve në këmbim të zgjidhjes së një problemi në universitet.

Grafik Nr. 7. Paraqitje grafike e rezultatit të pyetjes mbi perceptimin e Pranueshmërisë për dhënien e favoreve ne universitet




Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Grafik Nr. 8., Paraqitje grafike e rezultatit të pyetjes mbi perceptimin e zbatimit të ligjit nga policia

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Në këtë rast vëmë re se një përqindje e konsiderueshme 82.81% e të anketuarve kanë mendimin që ligji nuk zbatohet njësoj nga policia e shtetit.

Grafik Nr. 9., Paraqitje grafike e rezultatit të pyetjes mbi perceptimin e paanshmërisë së gjykatave

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Në lidhje me pyetjen nëse janë të paanshëm gjyqtarët në Shqipëri vëmë re se shumica e studentëve 78.13% kanë dhënë përgjigjen “jo”.

Të pyetur se cili nga elementët është motivi kryesor prapa praktikave korruptuese shumica e studentëve të anketuar 29.7% mendojnë se motivi kryesor prapa praktikave korruptuese është “Për të pasur burim alternative të të ardhurave”, më pas kategoria e dytë

më e përzgjedhur është “Nuk ka mënyrë tjetër për të kryer punë” me 24.3% të të anketuarve.


Tabela Nr. 8, Rezultat e pyetjes mbi perceptimin motivit me kryesor prapa praktikave korruptuese

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Nuk ka menyre tjetër për të kryer punë.	15	23.4	23.4	23.4
Per të marre sherbim preferencial/privilegje.	9	14.1	14.1	37.5
Per të pasur burim alternativ të ardhurave.	19	29.7	29.7	67.2
Per të persheptuar proceset/procedurat.	10	15.6	15.6	82.8
Per të shmangur ndeshkimet/sanksionet.	11	17.2	17.2	100
Total	64	100	100	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Në lidhje me pyetjen e mësipërme shumica e studentëve të anketuar rreth 43.75% e tyre kanë zgjedhur përgjigjen “Do të paguaja nëse nuk do të kisha mundësi tjetër për të zgjidhur problemin”.

Grafik Nr. 10., Paraqitje grafike e rezultatit të pyetjes mbi gatishmërinë e dhënies së rryshfetit



16. Ju personalisht a do të jepni rryshfet zyrtarit që në mënyrë të hapur ju kërkon para për t'iu zgjidhur ndonjë problem madhor tuajin?

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

Të pyetur se çfarë duhet bërë për uljen e korrupsionit shumica e të anketuarve (37.5%) ndajnë mendimin që duhet të ndryshojë mentaliteti i njerëzve. Më pas 28.1% e të anketuarve mendojnë që për të ulur nivelin e korrupsionit duhet që të rritet funksionalizimi i gjykatave

Tabela Nr. 9, Rezultat e pyetjes mbi perceptimin motivit me kryesor prapa praktikave korruptuese

Alternativa	Frequency	Percent
Funksionalizimi i Gjykatave.	18	28.1
Nderrimi i mentalitetit te njerezve.	24	37.5
Nderrimi i qeverise.	9	14.1
Puna me e mire e prokurorise	3	4.7
Puna me e mire e policise.	3	4.7

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

2. MENDIMI PËR ECURINË E KORRUPSIONIT

Në lidhje me pyetjen se si do të jetë korrupsioni ne vitin 2020 shumica e studentëve (53.1%) mendojnë se “nuk do të ketë ndryshim të rëndësishëm”.

Tabela Nr. 10 Rezultat e pyetjes mbi perceptimin e të ardhmes së korrupsionit

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Do te rritet ndjeshem.	7	10.9	10.9	10.9
Do te rritet.	8	12.5	12.5	23.4
Do te ulet	5	7.8	7.8	31.3
Valid Do te ulet ndjeshem	6	9.4	9.4	40.6
Nuk do kete ndryshim te	34	53.1	53.1	93.8
Nuk e di	4	6.3	6.3	100
Total	64	100	100	

Burim: Përpunimi i të dhënave të pyetësorit

3. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

3.1.Përfundime

- Përfundimisht nga studimi që kemi bërë, ku janë anketuar 64 studentë të Universitetit Të Vlorës “*Ismail Qemali*”, është gjetur se shumica e studentëve kanë perceptimin se në institucionet publike shqiptare ka korrupsion në nivele të larta.
- Anketimet treguan se në 11 institucione niveli i korrupsionit e kalon shifrën mbi 50% në shumicën e institucioneve. Vetëm dy institucione, institucionet e arsimit të ulët dhe organizatat jo qeveritare dalin me nivel korrupsioni nën 50%. Megjithatë perceptimi i korrupsionit për këto institucione është i lartë (45.33%).

-
- Perceptimi i përgjithshëm i studentëve në lidhje me korrupsionin është në masë 56.16%.
 - Perceptimi i përgjithshëm i studentëve meshkuj në lidhje me nivelin e korrupsionit është në masën 56.5%.
 - Perceptimi i përgjithshëm i studenteve femra në lidhje me nivelin e korrupsionit është në masën 55.5%.
 - Për sa i përket perceptimit për nivelin e përgjithshëm të korrupsionit institucioni që shihet me nivel më të lartë të korrupsionit është gjykata me 64.5%, më pas institucioni i dytë me nivel korrupsionit më të lartë është prokuroria me 63% e ndjekur nga institucionet e arsimit të lartë me 61.6%.
 - Për sa u përket meshkujve dhe femrave shohim se sipas meshkujve institucioni me nivelin më të lartë të korrupsionit është gjykata me 67.16%, kurse sipas femrave është shëndetësia me nivel 63.16%. Më pas sipas meshkujve institucioni i dytë më i korruptuar është prokuroria me 65.16%, kurse sipas femrave institucioni i dytë me nivelin më të lartë të korrupsionit është arsimit i lartë me 62.66%. Kurse për sa i përket institucionit të tretë me nivelin më të lartë të korrupsionit sipas meshkujve është qeverisja qendrore me 64.83%, kurse sipas femrave është gjykata me 61.5%.
 - Përsa i përket vendbanimit vëmë re se studentët të cilët jetojnë në zonë urbane kanë perceptimin që niveli i korrupsionit është më i lartë në prokurori me mesatare 65%, kurse studentët që jetojnë në zonën rurale kanë perceptimin që niveli i korrupsionit është më i lartë në gjykatë me 65.33%. Me pas studentët që jetojnë në zonën urbane rendisin si institucionin e dytë me nivel korrupsionit më të lartë gjykatën me 64.16%, kurse studentët që jetojnë në zonë rurale rendisin si institucionin e dytë me nivel më të lartë të korrupsionit shëndetësinë me 62.5%.
 - Shumica e studentëve 29.6% shohin papunësinë si problemin më shqetësues për qytetarët e shqipërisë.
 - 59.38% e studentëve të anketuarve mendojnë se korrupsioni është fenomeni më kërcënues për ta.
 - Për sa i përket arsyes kryesore të prezencës së korrupsionit në Shqipëri shumica e studentëve rreth 32.81% kanë perceptimin që arsyeja kryesore e prezencës së korrupsionit është dëshira për pasurim të shpejtë.
 - Shumica e studentëve shprehen se për të ulur nivelin e korrupsionit duhet të ndryshojë mentaliteti i njerëzve.
 - 53.1% e studentëve të anketuar kanë mendimin që niveli i korrupsionit nuk do të ketë ndryshim të rëndësishëm në vitet në vazhdim. Pra shumica e studentëve shprehen skeptik në lidhje me të ardhmen për luftën kundër korrupsionit.

3.2.Rekomandime

- Formimi politikave kundër korrupsionit është një rëndësi shumë e veçantë dhe duhet të rritet bashkëpunimi reciprok midis qytetarëve dhe shtetit.

-
-
- Në rend të parë është sigurimi i gjyqësisë së pavarur, në zbulimin dhe dënimin e korrupsionit.
 - Rrugë më të ndërlikuara të përballjes me korrupsionin janë ato që synojnë parandalimin e tij. Ato lidhen me ndërtimin dhe forcimin e institucioneve, të sistemeve dhe procedurave të tilla që të jenë të afta, nga njëra anë, të pakësojnë sa të jetë e mundur faktorët dhe stimujt që i shtyjnë njerëzit, që punojnë në to, të përfshihen në korrupsion dhe, nga ana tjetër, të rrisin sa më shumë stimujt që i shtyjnë njerëzit të largohen prej tij. E thënë shkurt, parandalimi i korrupsionit lidhet me qeverisjen e mirë.
 - Një faktor i rëndësishëm i strategjive parandaluese është kundërshtimi, gjithnjë e më i qëndrueshëm, ndaj korrupsionit prej qytetarëve si përdorues të shërbimeve publike. Kjo kërkon që qytetarëve t'u sigurohet mundësia të njohin, jo vetëm të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, por edhe pasojat që sjell korrupsioni për shoqërinë dhe për ta si individë. Një gjë e tillë do të mund të ishte më e efektshme, nëse do të ishte pjesë e një politike më të gjerë, që krahas synimit për krijimin e një qytetarie të mirë do të kishte si objektiv, veçanërisht në fushën e arsimit, që nxënësit të dalin nga shkolla me bindjen se kundërshtimi i korrupsionit shkon përtej interesit të tyre vetjak dhe bazohet në pikëpamjen e përbashkët për tiparet e kësaj lloj qytetarie.

4. REFERENCA

1. Teknikat statistikore me shumë ndryshore me aplikim në SPSS, përkthyer nga Prof. Dr. Seref Kalayci
2. Statistikë – Njohuri themelore. Prof. Dr. Ll. Puka, Dr. M. Ramosaçaj
3. <http://levizjafol.org/wp-content/uploads/2016/11/SKENIMI-I-KORRUPSIONIT-20161.pdf>
4. <http://www.amchamksv.org/wp-content/uploads/2018/03/Studimi-mbi-Perceptimin-e-Korrupsionit.pdf>
5. https://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/SAEK/2014%20Final%20Report_UNDP_Opinion%20Poll_Corruption%20in%20Education%20ALB.pdf
6. <https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/09/ALB-Survey-2017-ALB.pdf>
7. https://pashtriku.bëpworld.de/files/kosova_2010/mars_2010/elife_luzha_kashtkorrupsioni_31.3.10
8. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806ec1a3>